



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 4 datë 28.1.2021

**“PËR MIRATIMIN E PËRFITUESVE TË GRANTIT TË MENJËHERSHEM PËR
BANESAT ME KOSTO TË ULËT PËR VITIN 2021”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 28.1.2021, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje nenit 24 pika 2 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; pika 5 e nenit 15, nenit 46 dhe pika 10 e nenit 77 të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social“, VKM nr. 384 datë 12.06.2019 “Për caktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, neni 11 i VKM nr. 555 datë 15.7.2020 “Për procedurat, kriteret dhe përparësitë për akordimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët nga buxheti i shtetit“ Aktit Normativ nr.3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, VKB nr. 2, datë 22.01.2020 "Për miratimin e ngritjes, përbërjes dhe funksionimit të komisionit të strehimit", Shkresa nr. 773 prot. datë 15.01.2021 “Mbi fondet për programin e strehimit për vitin 2021“ të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Proçes-verbal përfundimtar i Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë Shkodër nr. Prot. 200/b/1 datë 25.01.2021 "Për instrumentin financiar “Akordimi i grantit te menjehershëm në zbatim të programit të strehimit social “Banesa me kosto të ulët”, si dhe relacionit të hartuar nga administrata bashkisë Shkodër, me 27 vota Pro,

V E N D O S I:

1. Të miratojë përfituesit e Grantit të menjëhershëm që akordohet nga buxheti i shtetit për banesat me kosto të ulët, për vitin 2021, sipas listës bashkengjitur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Sekretar i Këshillit


Denis Lesha

KRYETARE



Tabela e përfituesve të Grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët

	Emër/ Atësi/Mbiemër	Kontrata e lidhur me EKB	Vlera e shit - blerjes sipas kontratës / lekë	Shuma e grantit që kërkohet nga buxheti (10% e vleres se kontratës)
1	Illirjan Fran Mhilli	Nr.rep 838, nr. kol. 337 datë 19.05.09	2,846,186	284,618.6
2	Suzana Rexhep Tafili	Nr.rep 26, nr. kol. 2 datë 09.01.2009 Formular nr.10 "Rillogaritje sipas akt kontrollit të dt.21.12.2010"	2,897,390	289,739

